Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

01/Nr. 9649/2026
Data: 19.10.2026

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 28.09.2026 me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Takim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**
3. **Takim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.**
4. **Eventuale.**

Kryesuesi thekson:- para se me proceduar me rendin e ditës kërkoj nga ju që të jeni pro leximit të një deklarate kundër dhomave të specializuara, pasi që të gjithë jeni pro leximit të kësaj deklarate atëherë do ta lexojë. Deklaratë , ne anëtarët e komitetit për komunitete jemi kundër vendimit të dhomave të specializuara të Gjykatës së Hagës për krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës , vendimi është i pa pranueshëm duke u thirrur në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës, ne jemi me çlirimtarë dhe do të qëndrojmë me ta deri në lirimin përfundimtarë të tyre.
Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kryesuesi thekson: stadiumi i qyteti është planifikuar për vitin 2027, 2028, 2029 por Kryeministri në detyrë ka premtuar që do të rregullohet dhe mjetet financiare tonat a janë bashkë investim apo. Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Arbenita Bajramaliu thekson: unë kam propozuar që të jetë si kodë me një shumë të vogël të mjeteve për shkak se Ministria ka me përfunduar vetë.

Erblin Meliqi thekson: Organizata e Veteranëve të Luftës nëpër komunat tjera homazhet të cilat i bëjnë për nderim të dëshmorëve të secilit vend të cilët kanë rënë, a kishte mundur kjo pjesë me i takuar OVL-së e komuna me marr pjesë në thirrje të OVL-së për shkak se e kam pa që komuna jonë e bënë thirrje vetë . Është mirë me qenë përgjegjës OVL-ja për shkak të bashkëpunimit që e ka me komunën dhe vetë faqja e OVL-së duhet të bënë thirrje për homazhe e ndoshta kishte pasur unitet më të madh.

Arbenita Bajramaliu thekson: unë mundem me bërë një takim të përbashkët për me diskutuar dhe ne jemi përsëri këtu dhe do të marrim pjesë.

Sead Vila thekson: orët e para të cilat po mbahen për ditët e dëshmorëve është e mirëseardhur dhe është e mirë por po më doket që ka mësimdhënës të cilët nuk kanë shumë njohuri për ngjarjet, për dëshmorin, për historikun dhe po kam frigë se ndoshta ndonjëherë po devijojnë edhe realiteti i një vlere apo i një merite që ka një dëshmorë. Më e mirë do të ishte që me u krijuar një ekip çoftë brenda drejtorisë në bashkëpunim me mësimdhënësit të cilët janë të lëndës së historisë të cilët lidhen me këto ngjarje edhe festive por edhe për ditët e veçanta të cilat janë të dëshmorëve në mënyrë që me dal pak më unifikues. Mendoj që nuk është punë e vështirë me u bërë një harmonizim i gjithë këtyre dëshmorëve sepse janë librat të cilat janë botuar dhe me pasur një far kalendari që për secilën ngjarje me pas një realitet të përbashkët pra me dal njëjtë.

Kryesuesi thekson: unë mendoj që kjo mundet me u bërë në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit dhe me dal me një formë të një vendimi në mënyrë që secilës shkollë me ja përcjellë.

Arbenita Bajramaliu thekson: është mirë me bërë një takim me profesorët e historisë të cilët i njohin mirë këto çështje.

Ibadete Kuka thekson: te salla sportive te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" a keni në planë me rregulluar në këtë vit.

Arbenita Bajramaliu thekson: jemi duke e hartuar projektin për renovimin e të gjitha sallave sportive.

Valmira Bushi thekson: a keni planifikuar me i rritur subvencionet në vitin tjetër.

Arbenita Bajramaliu thekson: besoj që po sepse për çdo vit subvencionet janë rritur.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.

3. Takim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi thekson: ju përgëzojë për punën të cilën e keni bërë për hartimin e buxhetit, puna juaj ka reflektuar aq mirë që unë si anëtarë i kuvendit të komunës jam shumë i kënaqur. Edhe te projeksionet e vitit 2028 dhe 2029 kam vërejtur që ka rritje deh është shumë mirë. Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Erblin Meliqi thekson: cilat janë projektet më kryesore në komunë gjatë vitit 2027.

Lindita Ballazhi thekson: janë disa projekte të hartuara për të cilat duhet të fillojë viti dhe mundet të iniciohen procedurat e prokurimit. Rikupëzimi dhe riasfaltimi i rrugëve "Xhemsedin Suma" , ndërtimi i tregut ditorë, rregullimi i sheshit të qytetit, ndërtimi i Hanit të vjetër tre de . Kemi edhe projekte të tjera standarde kubëza betoni, riparime, ndriçimi publikë. Ka edhe kërkesa për të cilat kemi pasur kërkesa prej qytetarëve.

Ibadete Kuka thekson: a është planifikuar ura te mbikalimi te hekurudha që në vitin 2027 me u rregulluar.

Lindita Ballazhi thekson: nuk është ndonjë projekt sa i përket mbikalimit aty por kemi një projekt tjetër për të cilin nuk kemi buxhet dhe është projekti ndërtimi i mbikalimeve te rruga Martirët Bushi.

Sead Vila thekson: mungon emri i fshatit Neqafc në ndarjet buxhetore kur bëhen edhe pse është fshat i pa pabanueshëm, mungon edhe emri i kroit të cilin e kam kërkuar nuk është përfshirë në kornizën afat mesme buxhetore . Është zona te pishat që në të ardhmen ka me u shfrytëzuar për turizëm por më duket që me u anashkaluar ai fshat nuk figuron as për investime të ujit, kupëzave dhe investime të tjera.

Lindita Ballazhi thekson: te buxhetimi më vijnë kërkesat prej drejtorive , prej dëgjimeve buxhetore , takimet me shefat e grupeve parlamentare dhe unë vetëm i buxhetojë dhe nuk përfshihem fare në përfshirje të fshatrave .

Kryesuesi thekson: pasi që nuk është prezent askush nga bashkësia islame kalojmë në pikën e radhës.

5. Eventuale

Kryesuesi thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:58.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

Kryesuesi i Komitetit
Basri Dermjani